

Fillimi > -Kronikë

Konflikti në Vlorë, arrestohet për tentativë vrasjeje efektiv i forcave Delta (Emri)

30 Prill, 2022 10:10



Madhësia e tekstit: − +

VLORE
Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Vlorë arrestoi në flagrancë punonjësin e policisë të repartit Delta Forcë, si të dyshuar për veprën penale “Vrasje e mbetur në tentativë” për konfliktin e ndodhur pasditen e djeshme në Vlorë. Sipas AMP, dje rreth orës 18:55, në lagjen “10 Korriku”, pas një konflikti për motive të dobëta, dyshohet se punonjësi i policisë, Inspektor Lisjan Myrtaj, ka qëlluar me armë zjarri pistoletë (armën personale të punës) ndaj shtetasit Juxhin Todi (Aliaj), i cili ka qenë duke drejtuar mjetin tip “Benz”. Nga të shtënat nuk ka pasur të dëmtuar, ndërsa shtetasi Juxhin Todi është larguar nga vendngjarja duke braktisur mjetin. Menjëherë pas marrjes dijeni nga salla operative, nga ana e oficerëve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Rajonale të AMP Vlorë, nën drejtimin e prokurorit të gatshëm, është krijuar grupi hetimor, i cili ka kryer veprimet hetimore procedurale në vendngjarje, ku janë sekuestruar;
– një armë zjarri e llojit pistoletë
– 7 gëzhoja 9 mm, të cilat dyshohen se i përkasin armës së punonjësit të policisë, Lisjan Myrtaj.
– 3 fishekë, model 54
– mjeti tip “Benz Mercedes”
– panjet filmike nga kamerat e ambienteve në zonën ku ka ndodhur ngjarja
Ndaj punonjësit të policisë, Inspektor Lisjan Myrtaj është vendosur masa e arrestit në flagrancë dhe materialet procedurale u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për kryerjen e veprës penale “Vrasje e mbetur në tentativë”, parashikuar nga Nenet 76 e 22 të Kodit Penal.

Hetimet vijojnë për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje.
AMP mbetet e përkushtuar në misionin e saj për garantimin e zbatimit të ligjit dhe fton qytetarët të denoncojnë çdo rast të abuzimit apo shkeljes së ligjit nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, duke telefonuar në numrin e gjelbër 0800 90 90

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Agjencia e Mbikëqyrjes Policore konflikti Vlore

TË NGJASHME

Merr flakë në ecje makina në autostradën Fier-Vlorë, ja çfarë thotë Policia
30 Prill, 2022

Mollë sherri një vajzë? "Më ndoqi dhe më qëlloi dy herë më armë", zbardhet dëshmia e policit në Vlorë: U vetëmbrojt
30 Prill, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Emrat/ Grabitën një shumë të konsiderueshme parash në banesën e 69-vjeçarit, arrestohen dy të rinjtë në Shkodër
01 Maj, 2022

01 Maj, 2022

Sherr për parkimin e makinave, rrihen me shkop e grushte dy persona në Durrës
01 Maj, 2022

Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Pogradec, lëndohet 33-vjeçari dhe bashkëshortja
01 Maj, 2022

01 Maj, 2022

Emri/ Përplasi për vdekje të moshuarin dhe u largua nga vendi i ngjarjes, arrestohet 45-vjeçari, drejtonte mjetin nën efektin e drogës

Aksident në autostradën Lishje-Fier, furgoni përplasët me traktorin, plagosen dy drejtuesit
01 Maj, 2022

Shtatë operacione dhe 485.5 kg lëndë narkotike të sekuestruar, prokuroria e Korçës: Hetimet gjashtë mujore çuan pas hekurave 19 persona

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Goditje kirurgjikale, Kaçe shënon në Greqi
01 Maj, 2022

VIDEO/ Inter vazhdon rrugën drejt titullit, zikaltërit bëjnë detyrën ndaj Udineses
01 Maj, 2022

VIDEO/ Milan afrohet me titullin, "Djallit" në versionin klinik ndaj Fiorentinës
01 Maj, 2022

Nesër Fiter Bajrami/ Kreu i KMSH-së, Bujar Spahiu uron besimtarët myslimanë: Zoti i gjithësisë na e pastë pranuar agjërimin
01 Maj, 2022

VIDEO/ 4 gola dhe vendi i parë, Manchester City "nuk lëshon pe" në Premier League, rimerr kryesimin
30 Prill, 2022

30 Prill, 2022

VIDEO/ Real Madrid zyrtarisht kampion, titulli i 35-të i Los Blancos në historinë e La Liga, "kurorëzohet" në mënyrën më të mirë sezonit




Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT



"Gjici nuk kënaqet as me një sulmues që bën 30 gola", Pejiç tregon prapaskenat te Kukësi: Longo ishte pranë largimit

01 Maj, 2022



VIDEO/ Barcelona i falet Depay dhe Busquets, Roma ngec ndaj Bolognas

01 Maj, 2022



Frika e një lufte bërthamore, Lavrov akuzon mediat perëndimore: Po keqinterpretojnë kërcënimet e Ruisisë, ne garantojmë se...

01 Maj, 2022



Beqiri: S'pritej më shumë këtë sezon, momenti nuk është i keq te Partizani

01 Maj, 2022



Zuckerberg rikthehet në listën e 10 më të pasurve në botë/ Si e shtoi pasurinë për 11 miliardë dollarë brenda vetëm një dite

01 Maj, 2022



Titulli çështje kohe te Tirana, Vrapit dhe Mema njëzëri: Kur je shumë pikë diferencë, mund të mos kesh impenjim maksimal

01 Maj, 2022

NA NDIQNI NË RRRJETET SOCIALE

